



REPUBLIKA E SHQIPERISË
PREFEKTI QARKU FIER

KOMITETI RAJONAL I LUFTËS KUNDËR
TRAFIKIMIT TË PERSONAVE, QARKU FIER

Lidhja nr.1

RREGULLORE

PËR FUNKSIONIMIN E KOMITETIT RAJONAL TË LUFTËS KUNDËR
TRAFIKIMIT TË PERSONAVE, NË QARKUN FIER

Në zbatim të pikës 3, të urdhrit **nr.6, datë 26.01.2017**, të Kryeministrit, “Për Krijimin e Komiteteve Rajonale të Luftës Kundër Trafikimit të Personave”, Komiteti Rajonal i Luftës kundër Trafikimit të Personave, Qarku Fier, referuar në vazhdim si Komiteti, miraton rregulloren për funksionimin e Komitetit Rajonal të Luftës kundër Trafikimit të Personave:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi i rregullores

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave dhe i detyrave të hollësishme të organizimit, funksionimit dhe marrëdhënieve të Komitetit me institucionet shtetërore dhe joshtetërore, përgjegjëse për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të personave, në nivel qarku.

Neni 2

Objektivat e rregullores

Hartimi dhe miratimi i kësaj rregulloreje ka si objektiv:

1. Të krijojë kornizën e nevojshme rregulluese për të realizuar një funksionim sa më të koordinuar dhe efektiv të Komitetit dhe të të gjithë anëtarëve të tij.
2. Të ndërtojë një kornizë, e cila u krijon strukturave të Komitetit mundësinë dhe hapësirat e nevojshme që në punën e tyre, të respektojnë parimet e llogaridhënies, transparencës dhe gjithëpërfshirjes.
3. Të sjellë në vëmendjen e Komitetit dhe të aktorëve të tjerë të përfshirë në luftën kundër trafikimit të personave detyrat dhe përgjegjësitë e gjithësecilit të parashikuara në ligje dhe akte të tjera nënligjore që rregullojnë fushën e parandalimit dhe të luftës kundër trafikimit të personave.

4. Të mundësojë profesionalizëm dhe qëndrueshmëri në veprimtarinë e Komitetit.

Neni 3 Bashkëpunimi

1. Komiteti dhe të gjithë anëtarët e tij udhëhiqen nga parimi i ndërtimit të marrëdhënieve pozitive, të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit midis tyre, si dhe aktorëve të tjerë të përfshirë në luftën kundër trafikimit të personave.
2. Komiteti punon në partneritet me shoqërinë civile, duke vlerësuar maksimalisht kontributin dhe angazhimin e tyre në parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të personave. Komiteti i fton OJF-të në mbledhjet e tij dhe krijon të gjitha lehtësitat e duhura që ato me vullnetin e tyre të bëhen pjesë aktive e tryezave teknike, si anëtarë me të drejta të plota.

KREU II

STRUKTURA ORGANIZATIVE E KOMITETIT

Neni 4 Krijimi i Komitetit

1. Komiteti është krijuar me urdhrin nr.6, datë 26.01.2017, të Kryeministrit, “Për Krijimin e Komitetit Rajonal të Luftës kundër Trafikimit të Personave, në çdo qark”.
2. Komiteti është ngritur me qëllim mbikëqyrjen dhe bashkërendimin e të gjithë aktorëve (shtetërorë dhe joshtetërorë) dhe veprimeve antitrafikim si dhe shtrirjen e punës mbrojtëse, parandaluese dhe intensifikimin e përpjekjeve antitrafik të qeverisë edhe në nivel rajonal/lokal.

Neni 5 Përbërja e Komitetit

1. Komiteti drejtohet nga Prefekti i Qarkut dhe në përbërje të tij janë të gjitha agjencitë shtetërore përgjegjëse për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të personave si dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit në nivel rajonal/lokal.
2. Të gjithë anëtarët e Komitetit janë të barabartë midis tyre dhe gjatë gjithë angazhimit dhe veprimtarisë në Komitet duhet të udhëhiqen nga parimet e solidaritetit, humanizmit dhe përgjegjësisë individuale:

Neni 6 Sekretariati teknik

1. Me qëllim sigurimin e mbështetjes administrative dhe logjistike të Komitetit pranë Prefekturës krijohet sekretariati teknik i Komitetit.
2. Për këtë qëllim Prefekti, në cilësinë kryetarit të Komitetit, cakton një person, i cili duhet të kujdeset për të gjithë veprimtarinë e Komitetit.
3. Sekretariati teknik ndihmohet nga përfaqësuesi i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, anëtar i tryezës teknike, i cili ka për detyrë të mbajë procesverbalin e mbledhjeve të tryezës teknike.
4. Në varësi të kapaciteteve dhe mundësive që ka Prefektura, pjesë e sekretariatit teknik të Komitetit mund të jenë edhe persona të tjerë me funksione dhe njohuri të thelluara, në fushën e luftës kundër trafikimit të personave, të cilët caktohen nga kryetari i Komitetit.

5. Kur arrihen të sigurohen fonde të mjaftueshme, ose kur e lejon struktura organizative e institucionit të Prefektit të Qarkut, pranë sekretariatit teknik të Komitetit, mund të krijohet një funksion i veçantë në rolin e koordinatorit rajonal për veprimtarinë e Komitetit në nivel qarku.

KREU III

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E KOMITETIT DHE TRYEZËS TEKNIKE

Neni 7

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komitetit

Komiteti, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij në të gjithë territorin e qarkut në zbatim të Strategjisë së Luftës kundër Trafikimit të Personave dhe planit të veprimit, nr.6, datë 26.01.2017, të Kryeministrit, si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore që rregullojnë fushën e luftës kundër trafikimit të personave, ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- a) Koordinon të gjitha veprimet, masat dhe aktorët antitrafikim në nivel rajonal/lokal.
- b) Kryen vlerësime periodike për situatën dhe bën përcaktimin e prioriteteve për veprim në nivel qarku, në përputhje dhe në zbatim të Strategjisë së Luftës kundër Trafikimit të Personave dhe planit të veprimit.
- c) Në bazë të studimeve dhe të vlerësimeve bën përcaktimin e nevojave specifike të qarkut si dhe të tendencave të fenomenit në nivel qarku.
- ç) Bën identifikimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit në nivel qarku, si dhe merr masat për mbrojtjen e tyre duke shfrytëzuar kapacitetet dhe mundësitë që ofron qarku.
- d) Bën identifikimin e individëve dhe të grupeve të rrezikuara nga trafikimi si dhe merr masa për ngritjen rrjeteve të mbrojtjes, me qëllim parandalimin e trafikimit.
- dh) Ndërmerr masa konkrete për parandalimin e trafikimit, nëpërmjet fushatave të ndërgjegjësimit, krijimit të mekanizmave të mbrojtjes dhe të referimit të rasteve.
- e) Shërben si bërthamë për trajtimin e nevojave sociale dhe ekonomike më të gjera të qarkut që lidhen me arsimin, shëndetësinë, mirëqenien sociale, fëmijët në nevojë, çështje të respektimit të rendit publik apo të trafikut rrugor etj.
- ë) Shërben si urë lidhëse ndërmjet Zyrës së Koordinatorit Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Personave dhe njërive të vetëqeverisjes vendore për koordinimin e veprimtarisë antitrafikim në nivel qarku.
- f) Me qëllim koordinimin e punës dhe shkëmbimin e eksperiencave pozitive Komiteti mund të krijoj aleanca me komitetet e tjera në nivel kombëtar. Një nga prefektët mban presidencën e aleancës gjatë një viti.
- g) Zbaton me përgjegjësi të gjitha detyrat dhe udhëzimet e lëna nga Komiteti Shtetëror për Luftën kundër Trafikimit të Personave, si dhe nga zëvendësministri i Punëve të Brendshme/Koordinatori Kombëtar për Çështjet e Luftës kundër Trafikimit të Personave.
- gj) Është partner vendor dhe pikë kontakti edhe për autoritetin përgjegjës për zbatimin e mekanizmit kombëtar të referimit të rasteve të viktimave të trafikimit.
- h) Raporton një herë në 3 (tre) muaj, tek zëvendësministri i Punëve të Brendshme/Koordinatori Kombëtar për Çështjet e Luftës kundër Trafikimit të Personave, për të gjithë veprimtarinë e tij.

Neni 8

Hartimi i planit të veprimit

Komiteti harton dhe miraton planin e veprimit, për një periudhë 1-vjeçare:

- a) Plani i veprimit duhet të jetë i bazuar në nevojat dhe specifikat e qarkut.
- b) Duhet të jetë në përputhje të plotë me Strategjinë e Luftës kundër Trafikimit të Personave dhe planit të veprimit.
- c) Në planin e veprimit duhet të përcaktohen qartë detyrat dhe aktivitetet, institucionet përgjegjëse si dhe afatet për realizimin e tyre.
- ç) Plani i veprimit, bazuar edhe në propozimet e tryezës teknike, duhet të miratohet nga Komiteti në mbledhjen e parë të tij, e cila si rregull duhet të zhvillohet brenda muajit janar të vitit, për të cilin hartohet ky plan veprimi.
- d) Plani i veprimit duhet të konsultohet, paraprakisht, me Zyrën e Koordinatorit Kombëtar për Çështjet e Luftës kundër Trafikimit të Personave.

Neni 9

Detyrat dhe përgjegjësitë e tryezës

teknike Tryeza teknike ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- a) Kujdeset për zbatimin e detyrimeve që i ngarkohen nga Strategjia e Luftës kundër Trafikimit të Personave dhe planit të saj të veprimit, si dhe planit të veprimit të miratuar nga Komiteti.
- b) Në kuadër të parandalimit dhe luftës kundër trafikimit të personave, bën identifikimin e problemeve parësore në nivel rajonal/lokal dhe merr masa për zgjidhjen e tyre.
- c) Mbledh dhe shkëmben të dhëna mbi identifikimin, referimin dhe zgjidhjen e rasteve konkreteç) Përcakton veprime të nevojshme për parandalimin e trafikimit dhe mbrojtjen e familjeve, grupeve, personave dhe fëmijëve në rrezik trafikimi dhe në situatë rruge.
- d) Mban përgjegjësi për zbatimin e detyrave të lëna nga Komiteti.
- dh) Çdo anëtar mban përgjegjësi për detyrat specifike të lëna për ndjekje dhe zbatim në emër të strukturës që ai përfaqëson.
- e) Nëpërmjet sekretariatit teknik të Komitetit raporton periodikisht tek Komiteti për veprimtarinë e saj të paktën 1 (një) herë në 3 muaj, por edhe më shpesh nëse e gjejnë të nevojshme, ose kur një gjë e tillë u kërkohet nga Komiteti.

Neni 10

Detyrat dhe përgjegjësitë e sekretariatit teknik

Sekretariati teknik i Komitetit ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- a) Nën kujdesin e veçantë të Kryetarit të Komitetit kujdeset për mbarëvajtjen e veprimtarisë së Komitetit dhe tryezave teknike antitrafikim.
- b) Mban, ruan dhe përditëson të gjitha kontaktet e anëtarëve të Komitetit dhe tryezave teknike antitrafikim.
- c) Kujdeset për organizimin e mbledhjeve, njoftimin e pjesëmarrësve, shkëmbimin dhe përgatitjen e materialeve përkatëse.
- ç) Ruan dhe administron me përgjegjësi të gjitha dosjet dhe të dhënat e përpunuara nga Komiteti dhe tryeza teknike, përfshirë edhe dosjet me të dhëna për raste të veçanta.
- d) Kujdeset për shkëmbimin e informacionit, midis anëtarëve të Komitetit dhe tryezës teknike, duke respektuar parimin e ruajtjes së konfidencialitetit dhe të sigurisë së të dhënave, sidomos të atyre që kanë të bëjnë me viktimat e trafikimit dhe me raste konkrete që janë në proces hetimi apo gjykimi.
- dh) Sekretariati teknik i Komitetit është përgjegjës për komunikimin e të

- dhënave dhe referimin e rasteve konkrete tek autoriteti përgjegjës.
- e) Është përgjegjës për përgatitjen e raporteve periodike dhe informacioneve të ndryshme, të cilat në emër të Komitetit duhet të dërgohen pranë Zyrës së Koordmatorit Kombëtar për Çështjet e Luftës kundër Trafikimit të Personave.

KREU IV

ORGANIZIMII MBLEDHJEVE TË KOMITETIT

Neni 11 Mbledhjet e Komitetit

1. Në zbatim të urdhrin nr.6 , datë 26.01.2017, të Kryeministrit, udhëzimeve dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore, Komiteti zhvillon mbledhje periodike, të paktën 1 (një) herë në tre muaj, por edhe më shpesh në varësi të nevojave dhe problematikave të hasura.
2. Mbledhjet e Komitetit thirren dhe drejtohen nga kryetari i Komitetit.
3. Për anën administrative dhe logjistike të zhvillimit të mbledhjeve kujdeset sekretariati teknik, i cili merr të gjitha masat për njoftimin në kohë të anëtarëve dhe të personave të tjerë që mund të ftohen në mbledhje.
4. Njoftimi për zhvillimin e mbledhjeve dërgohet, të paktën, 5 ditë pune përpara datës së mbledhjes, me shkresë ose, edhe në një formë tjetër (fax apo e-mail), për të cilën anëtarët e Komitetit kanë rënë dakord paraprakisht. Bashkë me njoftimin dërgohet edhe rendi i ditës si dhe një përmbledhje e çështjeve që do të trajtohen në mbledhje. Njoftimi për mbledhjen e radhës pasohet nga konfirmimi i pjesëmarrjes nga ana e anëtarit të ftuar. Në rast mospjesëmarrjeje, anëtari i ftuar duhet të njoftojë, me shkrim, duke parashtruar edhe arsyen e mospjesëmarrjes në mbledhje.
5. Përpara zhvillimit të çdo mbledhjeje sekretariati teknik përgatit një informacion për punën e bërë nga tryeza teknike, si dhe sjell në vëmendje të Komitetit çështje specifike, për të cilat është rënë dakord paraprakisht në mbledhjet paraprake të tryezës.
6. Për mbledhjen e radhës njoftohet, paraprakisht, Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Çështjet e Luftës kundër Trafikimit të Personave. Së bashku me njoftimin përcillen axhenda si dhe informacione të tjera që kanë të bëjnë me zhvillimin e mbledhjes.
7. Pas përfundimit të mbledhjes nga sekretari i Përgjithshëm i Komitetit përgatitet një raport i hollësishëm i cili i dërgohet zëvendësministrit të Punëve të Brendshme/ Koordinatorit Kombëtar për Çështjet e Luftës kundër Trafikimit të Personave si dhe për dijeni të gjithë anëtarëve të Komitetit.

Neni 12 Modalitetet e zhvillimit të mbledhjes

1. Mbledhja hapet dhe moderohet nga kryetari, i cili bën edhe prezantimin e rendit të ditës si dhe një përmbledhje të zhvillimeve të fundit të punës së Komitetit.
2. Në bazë të rendit të ditës, fjalën e marrin me radhë të gjithë anëtarët e Komitetit, të cilët krahas komenteve për çështjet e përcaktuara në rend dite, informojnë Komitetin edhe për veprimtarinë e strukturës që ai përfaqëson për periudhën midis dy mbledhjeve.

3. Gjatë zhvillimit të mbledhjes mbahet procesverbal nga sekretariati teknik, i caktuar paraprakisht nga kryetari i Komitetit.
4. Në procesverbal mbahet shënim edhe listëprezenca e pjesëmarrësve në mbledhje, përfshirë edhe emrat e anëtarëve që nuk kanë marrë pjesë.
5. Përpara se të zbardhet, procesverbali i mbledhjes shkëmbehet për komente me të gjithë anëtarët e Komitetit dhe në fund shërben si bazë për të përgatitur raportimin përkatës për periudhën (3 -muajore) midis mbledhjeve të Komitetit. Vendimet në Komitet merren nga të gjithë anëtarët me shumicë votash.
6. Në fund të mbledhjes, përveç zbatimit të planit të veprimit, nga Kryetari lihen detyra specifike për tu ndjekur nga Komiteti dhe anëtarët e tij.

Neni 13 **Mbledhjet e tryezës teknike**

1. Tryeza teknike, thirret dhe drejtohet nga drejtuesi i saj dhe mbledhet, së paku, një herë në 2 muaj, por edhe më shpesh dhe sa herë vlerësohet e nevojshme nga anëtarët.
2. Për organizimin e mbledhjeve të tryezës teknike, drejtuesi i tryezës asistohet nga sekretariati teknik i Komitetit.
3. Njoftimi për zhvillimin e mbledhjeve dërgohet, të paktën, 5 ditë pune përpara datës së mbledhjes me shkresë ose, edhe në një formë tjetër (faks apo e-mail), për të cilin anëtarët e tryezës kanë rënë dakord paraprakisht. Bashkë me njoftimin dërgohet edhe rendi i ditës, si dhe çdo informacion tjetër për të cilin anëtarët e tryezës duhet të njoftohen paraprakisht. Njoftimi për mbledhjen e radhës pasohet nga konfirmimi i pjesëmarrjes nga ana e anëtarit të ftuar. Në rast mospjesëmarrjeje anëtari i ftuar duhet të njoftojë me shkrim, duke parashtruar edhe arsyen e mospjesëmarrjes në mbledhje. Për mospjesëmarrjen në mbledhje anëtari i tryezës teknike është i detyruar të njoftojë edhe eprorin e drejtpërdrejtë.
4. Në mbledhjet e tryezës teknike diskutohen me hollësi të gjitha problemet dhe çështjet e parashtruara nga sekretariati teknik i Komitetit. Në këto mbledhje trajtohen dhe jepen zgjidhje për raste konkrete që kanë të bëjnë me viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit por edhe për raste të tjera në rrezik trafikimi.
5. Pas përfundimit të mbledhjes sekretariati teknik përgatit një informacion të hollësishëm, i cili i vihet në dispozicion Komitetit në mbledhjen e radhës, si dhe për dijeni të gjithë anëtarëve të tryezës.
6. Çdo 6-muaj, tryeza teknike bën një analizë të hollësishme lidhur me zbatimin e planit të veprimit. Në mbledhjen e fundit të vitit, tryeza teknike në bazë të vlerësimit të zbatimit të planit të veprimit, punon për hartimin e planit të ri të veprimit, të cilin ia propozon për miratim Komitetit.

Neni 14 **Modalitetet e mbledhjes së tryezës teknike**

1. Mbledhja hapet dhe drejtohet nga kryetari i tryezës teknike, që është, njëkohësisht, edhe Kordinator i Përgjithshëm i Institucionit të Prefektit të Qarkut.
2. Në fillim të mbledhjes, kryetari bën një prezantim të çështjeve kryesore që do të trajtohen në mbledhje si dhe një përmbledhje të zhvillimeve të fundit të punës së tryezës dhe Komitetit.

3. Në bazë të rendit të ditës fjalën e marrin, me radhë, të gjithë anëtarët e tryezës, të cilët krahas komenteve për çështjet e përcaktuara në rend dite, informojnë tryezën edhe për veprimtarinë e strukturës që ai përfaqëson për periudhën midis dy mbledhjeve.
4. Në pjesën e dytë të mbledhjes diskutohet për rastet konkrete të cilat referohen nga vetë anëtarët e tryezës. Gjatë trajtimit të këtyre rasteve në mbledhje qëndrojnë vetëm anëtarët të cilët duhet të jenë prezent për zgjidhjen e rastit.
5. Në mbledhje trajtohen problemet e vështirësitë e hasura në ndjekjen dhe zbatimin e detyrave konkrete dhe për këtë jepen sugjerime e rekomandime për zgjidhjen e tyre, të cilat i përcillen Komitetit.
6. Gjatë zhvillimit të mbledhjes mbahet procesverbal nga përfaqësuesi i Zyrës Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.
7. Në procesverbal mbahet shënim edhe listëprezenca e pjesëmarrësve në mbledhje, përfshirë edhe emrat e anëtarëve që nuk kanë marrë pjesë.
8. Përpara se të zbardhet procesverbali i mbledhjes shkëmbehet për komente me të gjithë anëtarët e tryezës teknike dhe në fund shërben si bazë për të përgatitur raportimin përkatës, për periudhën 3 -mujore, midis mbledhjeve të Komitetit.
9. Pas zbardhjes së procesverbalit të mbledhjes nga kryetari i tryezës me ndihmën e sekretariatit teknik dhe përfaqësuesit të Zyrës Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, përgatitet një informacion i hollësishëm për mbledhjen, i cili i vihet në dispozicion Komitetit dhe për dijeni të gjithë anëtarëve të tryezës teknike.

KREU V

MONITORIMI VEPRIMTARISË SË KOMITETIT

Neni 15

Mbikëqyrja e veprimtarisë së Komitetit

1. Prefekti drejton, mbikëqyr, kontrollon dhe koordinon të gjithë veprimtarinë e Komitetit dhe strukturave përbërëse të tij. Ai kujdeset për ndarjen e përgjegjësisë dhe zbatimin e të gjitha detyrave në nivel qarku, në kuadër të luftës kundër trafikimit të personave.
2. Për të gjithë veprimtarinë e tij Komiteti, nëpërmjet kryetarit, raporton dhe informon në vazhdimësi zëvendësministrin e Punëve të Brendshme/Koordinatorin Kombëtar për Çështjet e Luftës kundër Trafikimit të Personave.
3. Me qëllim sigurimin e një angazhimi institucional, të qëndrueshëm dhe efikas të të gjitha strukturave të vartësisë që janë pjesë e Komitetit, Prefekti vendos lidhje të drejtpërdrejta me titullarët e institucioneve në nivel qendror. Në rast të konstatimit të mangësive në ndjekjen dhe zbatimin e detyrave të strukturave shtetërore që janë pjesë e Komitetit, Prefekti informon titulluarin e institucioneve të përmendura më sipër me qëllim marrjen e masave të nevojshme për rregullimin e këtyre mangësive.

Neni 16

Administrimi i të dhënave dhe shkëmbimi i informacionit

Të gjithë anëtarët e Komitetit dhe të tryezës teknike, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, tregojnë kujdes të veçantë në administrimin e të dhënave duke respektuar parimin e konfidencialitetit, si dhe duke ndërtuar një sistem shkëmbimi të dhënash të sigurt, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave.

Neni 17

Mbajtja e kontakteve

1-Drejtuesit e Komitetit dhe tryezës teknike mbajnë një listë të përditësuar të anëtarëve dhe kontakteve të tyre (nr. telefoni/faxi; nr. celulari dhe adresë e-mail-i) sipas strukturave dhe funksioneve të përcaktuara në urdhrin nr.6, datë 26.01.2017, **të** kësaj rregulloreje.

2-Të gjitha strukturat përgjegjëse, përfshirë edhe agjencitë e tjera shtetërore dhe joshtetërore që janë pjesë e Komitetit dhe të tryezës teknike janë të detyruar në bazë të kësaj rregulloreje që të venë në dispozicion emrat e përfaqësuesve e kontaktet e tyre. Në rast të zëvendësimit të tyre, ata duhet të njoftojnë, brenda 2 javëve, nga momenti i zëvendësimit për zëvendësimin e bërë, duke realizuar në këtë rast edhe përditësimin e kontakteve.

KREU VII

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE DHE KALIMTARE

Neni 18

Raportimi i parë për zbatimin e rregullores

1. Brenda 1 muaji nga miratimi i kësaj rregulloreje, sekretariati teknik i komitetit me mbështetjen e tryezës teknike, përgatit një raport të hollësishëm për masat e marra në zbatim të asaj çfarë është përcaktuar në këtë rregullore. Ky raport i paraqitet kryetarit të Komitetit (Prefektit të Qarkut), si dhe i dërgohet për dijeni edhe Koordinatorit Kombëtar për Çështjet e Luftës kundër Trafikimit të Personave.
2. Kryetari nga ana e tij, pasi njihet me këtë raport, merr masa për rregullimin e mangësive dhe është përgjegjës për monitorimin e zbatimit të kësaj rregulloreje

Neni 19

Hyrja në fuqi

- 1.Me miratimin e kësaj rregulloreje,rregullorja e mëparshme e miratuar nga Komiteti,shfuqizohet.
- 2.Kjo rregullore hyn në fuqi më datë 28/ 03/ 2022.
- 3.Miratuar nga Komiteti Rajonal për Luftën kunder Trafikimit të Personave, Qarku Fier në mbledhjen e datës 28/ 03/ 2022 .



REPUBLIKA E SHQIPERISË
PREFEKTI I QARKUT FIER
KOMITETI RAJONAL ANTITRAFIKIM

Nr. 332 Prot.

Fier, më 28.03.2022

V E N D I M

Nr 01, datë 28.03 2022

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES SË KRAT FIER

Mbështetur në nenin 20 pika 1 të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, dhe në zbatim të Urdhrit Nr.6 datë 27.01.2017 “Për Krijimin e Komiteteve Rajonale të Luftës Kundër Trafikimit të Personave në çdo Qark” të Kryeministrit:

VENDOSI:

1. Miratimin e Rregullores së funksionimit të Komitetit Rajonal të Luftës Kundër Trafikimit të Personave (KRAT), të Qarkut Fier.
2. Ngarkohen anëtarët e KRAT Fier për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Në cilësinë e Kryetarit të KRAT Fier

PREFEKTI

Lefter SHEHAJ

